

Shejhul Islam
TEKIJUDIN AHMED BIN TEJMIJE

KODI I DURIMIT



Titulli i originalit

قاعدة في الصبر

Autori: Shejhul Islam Tekijudin Ahmed bin Tejmije
661 - 728 h (1263 – 1328) (*Allahu e mëshiroftë!*)

Përshtati në shqip: Edmond Ajdini

Redaktor gjuhësor: Qani Sulku



Boton: Qendra Kulturore Fetare “Udha e Besimtarëve”

Rr. Kajo Karafili, Pll. 8, Shk. 1, Ap. 12, Tiranë, Albania

Tel.: +35542247064, Mob.: +355 69 35 65 505, +355 67 25 67 863

e-mail: info@udhaebesimtareve.com

www.udhaebesimtarëve.com

Parathënie e shejhut të nderuar

ABDURRAZAK BIN ABDULMUHSIN EL BEDËR

(Allahu e ruajtë!)

BISMILAH I ERR-RAHMANI ERR-RAHIM

Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar!
Atë e lavdërojmë dhe prej Tij ndihmë dhe falje
kërkojmë! Me përvulje i shprehim pendesën për
mëkatet tona!

E lusim Allahun e Madhëruar të na ruajë nga
ligësia e veteve tona e të na mbrojë nga pasojat e
punëve tona të këqija!

Atë që Allahu e udhëzon në udhën e drejtë, s'ka
kush ta humbasë, e kush e humbet rrugën e drejtë,
askush përveç Allahut nuk mund ta udhëzojë.

Dëshmoj se nuk meriton të adhurohet askush dhe
asgjë përveç Allahut, Një dhe i Vetëm; pa ortak e
as të ngjashëm. Dëshmoj se Muhamedi është rob
i Allahut dhe i Dërguar i Tij. Paqja, mëshira dhe
bekimet e Allahut qofshin mbi të, familjen e tij të
ndershme dhe shokët e tij fisnikë!

Durimi është një virtyt i çmuar, që gëzon një pozitë të lartë në fenë islame. Allahu i Madhëruar e ka përmendur shumë herë fjalën ‘durim’ në Librin e Tij.

Imam Ahmedi (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: “Fjala ‘**DURIM**’ përmendet në Kuran më tepër se 90 herë.”¹

Natyrisht që ky fakt tregon për vlerën e madhe që ka durimi, si dhe për nevojën e madhe që ka njeriu për t’u pajisur me këtë virtyt të çmuar. Kryerja e obligimeve fetare kërkon durim, ashtu siç kërkon edhe distancimi nga çdo gjë prej të cilës ka ndaluar Allahu. Ballafaqimi me fatkeqësitë e jetës, gjithashtu kërkon durim dhe vetpërmbajtje, në mënyrë që njeriu të mos i humbasë shpresat nga mëshira e Allahut e të mos devijojë nga rruga e drejtë.

Ajetet kuranore, në të cilat Allahu i Madhëruar ka përmendur durimin, vijnë në trajta të ndryshme. Në shumë prej tyre gjejmë se Allahu i Madhëruar urdhëron që të pajisemi me durim, e në disa të tjera na tërheq vërejtjen, që të mos tregohemi të

¹ Shiko librin “Mederixhu Salikin” (1/130) të Ibnul Kajimit.

padurueshëm. Janë të shumta ajetet ku lavdërohen durimtarët dhe ku tregohet për shpërblimin e madh që Zoti ka përgatitur për ta, si dhe për përfundimin e mirë që do të kenë në botën tjetër. Allahu i Madhëruar i ka përgëzuar durimtarët dhe ka bërë me dije se i do, i mbron, i ndihmon dhe u gjendet pranë. Padyshim që të gjitha këto, dëshmojnë për vlerën e madhe të durimit.

Tematika e durimit është e gjerë dhe prek shumë sfera të jetës, por në këtë libërth do të mjaftohemi vetëm me njërin prej llojeve të durimit; **Me durimin që duhet të tregojë njeriu kundrejt shqetësimeve që mund t'i shkaktojnë të tjerët.**

Njeriu gjatë jetës së tij nuk shpëton pa rënë pre e shqetësimeve dhe lëndimeve, që me dashje apo pa dashje ia shkaktojnë të tjerët. Kjo sepse njerëzit janë të natyrave të ndryshme dhe dallojnë nga njëri-tjetri në sjellje, moral dhe temperament.

Një marrëdhënie e suksesshme ndërnjerëzore, patjetër që kërkon durim. Ndër llojet më të rëndësishme të durimit është edhe ai kundrejt shqetësimeve apo dëmeve që na shkaktojnë të tjerët.

Duke qenë se tek shumica e njerëzve mungon vullneti dhe gatishmëria për ta pasur këtë lloj durimi, lind si detyrë t'i referohemi udhëzimeve dhe këshillave të dijetarëve, në mënyrë që të mësojmë për vlerën dhe rëndësinë e të pajisurit me këtë virtyt të çmuar. Natyrisht që këshillat dhe udhëzimet e dijetarëve, për ne janë si pishtarë ndriçues dhe dritë që na orientojnë në udhë të mbarë.

Në fokus të këtij libërthi do të jetë shpjegimi i një sërë shkaqesh të dobishme që e ndihmojnë njeriun të jetë më i durueshëm kundrejt shqetësimeve që i vijnë nga të tjerët. Autori, dijetari i nderuar, shejhul islam Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) i ka përmbledhur dhe i ka sqaruar këto shkaqe të dobishme në një mënyrë tepër të mrekullueshme dhe mbresëlënëse, gjë të cilën vështirë ta hasësh në ndonjë libër tjetër.

Allahu e mëshiroftë këtë dijetar të madh dhe imam të nderuar për këtë përmbledhje të rrallë e tepër të dobishme! Allahu e shpërbleftë për mundin e tij dhe e bëftë banor të xhenetit Firdeus!

Lus Allahun e Madhëruar të na bëjë prej robërve të Tij durimtarë, si dhe të na bëj falënderues të mirësive, pasi siç dihet “durimi” gjatë vështirësive dhe sprovave është gjysma e fesë, ndërsa gjysma tjetër është falënderimi për mirësitë e panumërta.

Lus Allahun e Madhëruar të na bëjë dobi me atë çfarë na ka mësuar e të na e shtojë edhe më tepër diturinë! Lus Allahun që dijet tona të jenë argument për ne e jo kundra nesh! Vërtetë Zoti i Lartmadhëruar është pranë çdo lutësi; i dëgjon lutjet dhe u përgjigjet atyre!

*AbduRrazak bin
Abdul Muhsin El Bedër*

BISMILAHİ ERR RRAHMANI ERR RRAHİM

O ALLAHU İM, NA FAL DHE NA MËSHIRO!

Dijetari i mirënjohur, shejhul islam Tekijudin Ebu el Abbas Ahmed bin Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë:

Allahu i Madhëruar u ka mundësuar robërve të Tij besimtarë që të dalin të fituar në çdo gjendje që përjetojnë. Nëse atyre u ndodh diçka që i gëzon, ata falënderojnë Allahun dhe kjo është mirë për ta, e po ashtu, nëse u ndodh ndonjë fatkeqësi, bëjnë durim duke llogaritur shpërblimin tek Zoti i tyre, kështuqë edhe kjo është mirë për ta.

Pra, besimtarët janë në mirësi, edhe kur u ndodh diçka që i gëzon, edhe kur i godet ndonjë fatkeqësi. Allahu i Madhëruar ka caktuar që situatat dhe gjendjet që do t'i përjetojnë robërit e Tij besimtarë, të bëhen shkak për ta për fitimin e sevapeve të shumta dhe për afrimin e tyre sa më pranë Zotit.

Këtë e ka bërë të qartë i Dërguari i Allahut (Paqja goftë mbi të!) ku ka thënë: *“Është për t’u habitur çështja e besimtarit! Çdo gjendje që ai përjeton është mirë për të, e nuk e arrin këtë mirësi askush tjetër përveç besimtarit. Nëse i ndodh diçka e mirë, falënderon (Allahun) e kjo i sjell dobi, e nëse e godet ndonjë e keqe, bën durim, e edhe kjo është në të mirën e tij (i shkruhet sevapi për durimin)”*².

Ky hadith tregon qartazi se besimtarët janë gjithmonë në mirësi, edhe kur u ndodh diçka që i gëzon, po ashtu edhe kur i godet ndonjë fatkeqësi, me kusht që të jenë falenderues ndaj mirësive dhe të durueshëm ndaj sprovave dhe fatkeqësive. Madje kjo çështje ka të bëjë me besimin, pasi ashtu siç kanë thënë të parët tanë të mirë, besimi ndahet në dy gjysma; njëra prej tyre është durimi (kundrejt fatkeqësive) dhe gjysma tjetër falënderimi ndaj mirësive. Allahu i Madhëruar thotë:

إِنَّ فِي ذَلِكَ لآيَاتٍ لِّكُلِّ صَبَّارٍ شَكُورٍ

“Vërtet, në këtë ka argumente për çdo njeri që është i durueshëm dhe falënderues.” Ibrahim: 5

² E transmeton Muslimi.

Nëse mediton thellë rreth fesë në tërësi, do të shikosh se e gjitha vërtitet midis durimit dhe falënderimit.

Sa i takon durimit, mund të themi se llojet e tij janë tre:

- LLOJI I PARË: *Durimi në lidhje me kryerjen e obligimeve fetare*

Muslimani nuk mund t'i kryejë obligimet e marra përsipër, përveçse nëse tregon durim dhe përpiqet vazhdimisht, duke i bërë ballë tundimeve që duan ta pengojnë, qofshin ato të jashtme apo të brendshme. Në varësi të durimit dhe këmbënguljes do të jetë dhe rezultati i punës së tij, qoftë ajo punë obligative apo e pëlqyeshme.

- LLOJI I DYTË: *Durimi për t'u distancuar nga ndalesat e Zotit.*

Vetja e njeriut, nevojat që ajo ka, çytja e shejtanit të mallkuar, ndikimi i shoqërisë së keqe, të gjitha këto e shtyjnë njeriun drejt mëkatit. Gjithkush e ka të qartë se për t'u distancuar nga çfarë ka ndaluar Allahu nevojitet durim dhe vetpërmbajtje. Muslimani obligohet që ta frenojë

epshin e tij nga haramet dhe nga çfarë e dëmton. Sa më i durueshëm të tregohet ai, aq më shumë do ta distancojë veten e tij nga harami. Disa nga të parët tanë të mirë (selefët) kanë thënë: “Vepra të mira bën kushdo, i miri dhe i keqi, por nuk arrin të distancohet nga mëkatet veçse ai që është i sinqertë.”³

- **LLOJI I TRETË:** *Durimi gjatë fatkeqësive dhe sprovave të cilat i ndodhin pa dëshirën dhe vullnetin e tij.*

Këto ndahen në dy kategori:

- a. Në kategorinë e parë bëjnë pjesë ato fatkeqësi dhe sprova të cilave është e pamundur t’u shpëtosh, siç janë sëmundjet apo fatkeqësitë e ndryshme natyrore.

Gjatë këtyre sprovave, muslimani e ka disi më të lehtë të durojë, pasi gjen ngushëllim tek fakti se ato ndodhin të paracaktuara nga Allahu i Madhëruar dhe është e pamundur shmangia e tyre. Kështu që ato nuk kalohen ndryshe veçse me durim, qoftë ky durim me dëshirë apo me pahir.

³ “Hiljetu el evlija”, vëllimi 10, faqja: 197.

Nëse Allahu ia zgjeron kraharorin dhe e bën të kuptojë se ajo sprovë që e ka goditur mund të jetë shkak për arritjen e dobive të shumta dhe për largimin e ndonjë dëmi më të madh, atëherë ky njeri, jo vetëm që do ta ketë të lehtë të durojë, por do t'i jetë mirënjohës dhe falënderues Zotit të gjithësisë, duke qenë i bindur se Ai ia do të mirën robit të Vet. Ky njeri jo vetëm që do të jetë durimtar për sprovën që e ka goditur, por do t'i jetë mirënjohës Zotit të tij me zemër dhe me gjuhë e do të thotë: *“O Zoti im! Më ndihmo që të jem prej atyre që të madhërojnë, të falënderojnë dhe të adhurojnë Ty ashtu siç Ti e meriton!”* Natyrisht që kjo përjetohet në varësi të dashurisë dhe gradës së besimit që njeriu ka për Allahun e Madhëruar.

b. Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë shqetësimet dhe dëmet që ia shkaktojnë njerëzit e tjerë, qofshin ato në pasurinë, në nderin apo në veten e tij.

Durimi në të tilla raste është shumë i vështirë, pasi njeriu e ndjen veten të cënuar dhe të dhunuar në nderin dhe dinjitetin e tij, e nuk pranon të ndihet i mundur nga të tjerët, kështuqë kjo e nxit drejt hakmarrjes. Të tregosh durim në të tilla raste, do të thotë të ndjekësh shembullin

e durimit të profetëve dhe të sinqertëve. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) kur lëndohej nga dikush, thoshte: *“Allahu e mëshiroftë Musain! Atë e lënduan shumë më tepër se kaq dhe duroi.”*⁴

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) rrëfen për njërin nga profetët e mëparshëm, të cilin populli i vet e keqtrajtoi duke e goditur dhe gjakosur, ndërsa ai përsëriste fjalët: *“O Allah! Fale popullin tim se nuk dinë çfarë bëjnë!”*⁵ Diçka e ngjashme i ka ndodhur edhe Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), e ai kishte thënë: *“O Allah! Fale popullin tim se ata nuk e dinë se çfarë janë duke bërë!”*⁶

⁴ E transmetojnë Buhariu me nr (3405) dhe Muslimi, vëllimi: 3, faqja: 109.

⁵ E transmetojnë Buhariu me nr (3477) dhe Muslimi, vëllimi: 5, faqja: 179.

⁶ Këtë e transmeton Abdullah bin Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili ka thënë: “Kur i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ndau plaçkën e luftës së Hunejnit, njerëzit u dyndën tek ai. Në atë rast, ai u tha: **“Allahu i Madhëruar e dërgoi një profet tek populli i tij ndërsa ata u sollën keq me të, e rrahën dhe e gjakosën, ndërsa ai thoshte: “O Zot! Fale popullin tim se ata nuk e dinë se çfarë janë duke bërë!”** - Abdullahi tregon: “A thuaj se jamë duke e parë Profetin duke e fshirë gjakun nga balli i tij, ashtu siç kishte vepruar ai profet me popullin e tij dhe përsëriste fjalët: **“O Zot! Fale popullin tim se ata**

Në këtë lutje gjenden tre mirësi:

- *E para: Profeti e fali popullin e vet për dhunën e ushtruar ndaj tij.*
- *E dyta: Iu lut Allahut që t'i falë ata e të mos i ndëshkojë.*
- *E treta: I justifikoi me faktin se ishin të paditur.*

Shiko pra se çfarë mëshire kanë treguar profetët kundrejt njerëzve, madje edhe kundrejt atyre që janë sjellë ashpër me ta!!

Padyshim se ai që duron në këtë mënyrë do të ndihmohet nga Zoti e do të jetë triumfues. Atij Allahu do t'i japë krenari, qetësi e sukses. Atë do ta dojë Allahu e do ta duan edhe njerëzit. Atij do t'i hapen dyert e dijes dhe urtësisë, siç thotë Allahu i Madhëruar:

وَجَعَلْنَا مِنْهُمْ أُمَّةً يَهْدُونَ بِأَمْرِنَا لَمَّا صَبَرُوا ۗ وَكَانُوا بِآيَاتِنَا يُوقِنُونَ

“Ne bëmë prej tyre prijës që udhëzonin me urdhrin Tonë, pasi u treguan të durueshëm dhe argumentet tona i besuan bindshëm.” Sexhdeh: 24

nuk e dinë se çfarë janë duke bërë!” E transmeton Imam Ahmedi në Musnedin e tij, vëllimi: 7, faqja: 376, me nr (4366).

Me anë të durimit dhe bindjes së plotë në besim, Zoti e lartëson njeriun dhe i jep pozitë të lartë në fe. Kur këtij durimi i shtohet edhe forca e besimit të sinqertë, ai arrin piedestalet më të larta të lumturisë, me lejen e Allahu! Kjo është mirësi e Allahut të cilën ia jep kujt të dojë! E padyshim që Allahu është Zoti i të gjitha mirësive.

Allahu i Madhëruar thotë:

وَلَا تَسْتَوِي الْحَسَنَةُ وَلَا السَّيِّئَةُ ۗ ادْفَعْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ فَإِذَا
الَّذِي بَيْنَكَ وَبَيْنَهُ عَدَاوَةٌ كَأَنَّهُ وَلِيٌّ حَمِيمٌ وَمَا يُلْقَاهَا إِلَّا الَّذِينَ
صَبَرُوا وَمَا يُلْقَاهَا إِلَّا ذُو حَظٍّ عَظِيمٍ

“Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Të keqen ktheje me mirësi, se atëherë ai, mes teje dhe të cilit ka armiqësi, do të bëhet si të ishte miku yt më i afërt. Mirëpo, këtë nuk e arrin kush, përveç atyre që janë të durueshëm, dhe nuk e arrin kush, përveç atyre që gëzojnë një mirësi të madhe.” El Fussilet, 34-35

Nga ky ajet kuranor kuptojmë se të durosh e të falësh, mund të mos jetë gjë e lehtë, por nëse njeriu duron dhe fal për hir të Allahut të Madhëruar, do të ketë shpërblim të madh, pikërisht Xhenetin.

**FAKTORËT QË E NXISIN NJERIUN TË JETË
I DURUESHËM KUNDREJT SHQETËSIMEVE
QË I SHKAKTOJNË TË TJERËT**

Duhet të dimë se janë një sërë faktorësh, që e ndihmojnë njeriun për të qenë më i durueshëm, kundrejt shqetësimeve që mund t'i shkaktojnë të tjerët.

Ndër to, përmendim:

1. Askush nuk mund të të dëmtojë pa lejen dhe paracaktimin e Allahut të Madhëruar!

Allahu i Madhëruar është Krijuesi i gjithçkaje, e rrjedhimisht që Ai ka krijuar edhe veprat e njerëzve; ka krijuar lëvizjet e tyre, qëndrimet e tyre dhe dëshirat e tyre. Çfarë ka dashur Allahu që të ekzistojë, ekziston, ndërsa çfarë Ai nuk ka dashur të ekzistojë, natyrisht që nuk mund të ekzistojë.

Nuk ndodh asnjë lëvizje, as në Tokë e as në qiell, madje as lëvizja e një atomi të vetëm, veçse me lejen dhe dëshirën e Allahut të Madhëruar.

Kështu që të jesh i bindur se askush nuk mund të të bëjë asgjë të keqe, pa lejen dhe paracaktimin e Zotit të Madhëruar.

Mos e fokuso vëmendjen te sjelljet e njerëzve, por rregullo marrëdhënien tënde me Zotin dhe hidhe tutje dëshpërimin dhe mërzinë!

SILL NDËRMEND GJYNAHET E TUA!

Mund të kenë qenë mëkatet e tua, se bepi (shkak) që Zoti po të sprovon me njerëz që të bien më qafë. Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin fisnik:

وَمَا أَصَابَكُمْ مِنْ مُصِيبَةٍ فَبِمَا كَسَبَتْ أَيْدِيكُمْ وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ (30)

“Çfarëdo e keqe që mund t’ju godasë, ajo është pasojë e veprave tuaja (të këqija), e për shumë të tjera Ai u falë.” Esh Shura, 30.

Nëse muslimani, sa herë që e mërzit dikush, apo sa herë që i ndodh diçka e pakëndshme, shikon si shkaktar për atë që i ka ndodhur “gjynahet e veta” dhe mangësinë e tij në lidhje me kryerjen e dispozitave të fesë, atëherë nuk do ta lodhë veten duke urryer njerëzit apo “fatin e tij të keq”, por do ta angazhojë veten me pendim të sinqertë dhe përmirësim të vetvetes, gjë e cila patjetër që do t’i bëjë dobi.

Kështu pra, nëse e sheh dikë që sa herë i ndodh diçka e pakëndshme fillon të grindet me njerëzit duke e kërkuar fajin tek ata, dije se veprimi i tij

është shumë i shëmtuar dhe gjendja e tij është për të ardhur keq.

Ndërsa, nëse njeriu, sa herë që i ndodh ndonjë e pakëndshme, pendohet tek Zoti duke qenë i bindur se shkak për problemet e tij janë gjynahet e tij, atëherë dije se ajo fatkeqësi që i ka rënë, ka për të qënë mirësi për të dhe ai do të dalë prej saj, në një gjendje më të mirë se ç'ishte më parë.

Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) ka thënë: “Nuk zbresin fatkeqësitë, veçse si pasojë e gjynaheve dhe nuk largohen, vetëm se duke u penduar prej tyre.”⁷

Po ashtu, Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) ka thënë: “Njeriu nuk duhet të shpresojë te askush tjetër, përveç Zotit të tij dhe nuk duhet t'i frikësohet asgjëje tjetër, përveç mëkateve të veta.”

Zoti ynë e ka thënë të vërtetën në Librin e Tij madhështor:

إِنَّ اللَّهَ لَا يُغَيِّرُ مَا بِقَوْمٍ حَتَّىٰ يُغَيِّرُوا مَا بِأَنفُسِهِمْ

“Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata ta ndryshojnë veten e tyre...” Err Rrað, 11.

⁷ Shiko librin “Edau ued Deau” f. 118.

**KUSH FAL E DURON,
SHPËRBLIMIN E KA TEK ZOTI**

Muslimani duhet të sjellë ndërmend shpërblimin e madh që Allahu i Madhëruar ua ka premtuar atyre që tregohen të durueshëm dhe falin. Allahu i Madhëruar thotë:

وَجَزَاءُ سَيِّئَةٍ سَيِّئَةٌ مِّثْلُهَا ۚ فَمَنْ عَفَا وَأَصْلَحَ فَأَجْرُهُ عَلَى اللَّهِ ۗ إِنَّهُ
لَا يُحِبُّ الظَّالِمِينَ

“Ndëshkimi i të keqes, bëhet në të njejtën masë, mirëpo kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është te Allahu. Vërtet, Ai nuk i do zullumqarët.”

Esh Shura, 40.

Njerëzit, kundrejt padrejtësisë që i'u është bërë, ndahen në tre kategori:

1. *Zullumqar, i cili hakmerret shumfish për të keqen që i është bërë.*
2. *Mesatar, i cili e kthen me të njejtën monedhë të keqen që i është shkaktuar, as më pak e as më shumë.*

3. *Zemërgjerë, i cili, edhe pse ka mundësi të marr hakun e tij, zgjedh që të falë për hir të Zotit.*

Në ajetin e mësipërm, janë cekur të treja: “Ndëshkimi i të keqes, bëhet në të njëjtën masë” – Ky është rasti i atij që tregohet mesatar.

“mirëpo kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është te Allahu” – Ky është rasti i atij që fal për hir të Zotit.

“Vërtet, Ai nuk i do zullumqarët” – Këtu flitet për ata që hakmerren më tepër sesa u takon.

Vlen të përmendim po ashtu hadithin në të cilin tregohet se Ditën e Gjykimit, një thirrës do të thërrasë: ‘Të ngrihen të gjithë ata të cilët kanë shpërblimin e garantuar tek Zoti!’ Dhe nuk ka për t’u ngritur askush tjetër përveç atyre që falnin për padrejtësitë e tyre dhe pajtonin mes njerëzve.”⁸

Nga Ebu Umeme (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) transmetohet se i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Unë ia garantoj një shtëpi në Xhenet atij që e ndërpret polemikën (heq dorë nga zënka), edhe nëse ka të drejtë”⁹.

⁸ Hadith i dobët. Shiko librin “Es Silsiletu ed daifeh”, 1277.

⁹ E transmetojnë Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe. Shejkh Albani e ka vlerësuar këtë hadith si *Hasen – I mire*. Shiko librin “Sahihu et tergib ue et terhib” vëllimi: 6, faqja: 3.

Nëse njeriu vetëdijësohet për shpërblimin e madh të Allahut të Madhëruar që ua ka premtuar atyre që falin gabimet e njerëzve, atëherë do ta ketë më të lehtë durimin dhe faljen ndaj tyre.

FALJA E FORCON NDJENJËN E VËLLAZËRISË DHE E LARGON URREJTJEN

T'ia falësh gabimin vëllait musliman (duke e këshilluar për zemërsisht atë), kjo do ta shtonte ndjenjën e vëllazërisë dhe do ta shuante urrejtjen dhe meritë e kota.

Falja është më e mirë se hakmarrja, pasi kjo e detyra mund ta shtojë armiqësinë dhe urrejtjen, madje mund të çojë në veprime edhe më të shëmtuara, siç janë mashtrimi, gënjeshtria, shpifja etj. Nëse njeriu fal për hir të Zotit, zemra e tij gjen prehje dhe qetësi. Madje, shija që lë falja dhe pajtimi, janë shumë më të ëmbla dhe të dobishme për njeriun se çdo hakmarrje dhe ndëshkim. Jo vetëm aq, por falja dhe mirësia ndaj tjetrit, bëhen shkak për të fituar dashurinë e Allahut të Madhëruar, i Cili thotë:

وَالْكَاطِمِينَ الْغَيْظَ وَالْعَافِينَ عَنِ النَّاسِ ۗ وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ

“(Bamirës janë edhe ata) të cilët e frenojnë mllëfin dhe u falin njerëzve gabimin, e padyshim që Allahu i do bamirësit.” Ali Imran, 134.

Njeriu i cili e frenon zemërimin dhe i fal gabimet

e njerëzve për hir të Allahut të Madhëruar, fiton dashurinë e Allahut, e kush është më fatlum sesa ai që ka fituar dashurinë e Tij?! Kjo i ngjan atij që ka humbur 1 monedhë flori, dhe është kompesuar për të me 1000 monedha floriri, kështu që ky njeri fatlum ka të drejtë t'i gëzohet mirësisë së Allahut ndaj tij.

HAKMARRJA NUK SJELL GJË TJETËR PËRVEÇSE MËRZI DHE DËSHPËRIM

Hakmarrja nuk i sjell njeriut asgjë tjetër, veçse mërzi dhe dëshpërim, ndryshe nga ç'sjell falja dhe pajtimi. Njeriut falës, Allahu i dhuron krenari, siç na ka lajmëruar në lidhje me këtë, i Sinqerti, i cili flet veçse të vërtetën, Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), i cili thotë:

“Njeriut zemërgjerë dhe falës, Allahu veçse ia shton edhe më tepër krenarinë dhe dinjitetin.”¹⁰

Krenaria e fituar prej zemërgjersisë dhe faljes, do t'i bëhet më e dashur dhe frytëdhënëse sesa krenaria e cila arrihet prej hakmarrjes dhe ndëshkimit.

Hakmarrja është krenari në dukje, ndërsa pas të gjurmë dobësie dhe përçmimi, ndërkohë që falja, fillimisht mund të ngjajë si dobësi dhe përlulje, por në të vërtetë, ajo është kulmi i krenarisë; krenari e dukshme që buron nga zemra.

¹⁰ Transmeton Muslimi në “Sahihun” e tij me nr 2588.

SHPËRBLIMI JEPET SIPAS VEPRËS

Ndër faktorët më të efektshëm që e nxisin njeriun të tregohet i durueshëm ndaj shqetësimeve dhe dëmeve që i shkaktojnë të tjerët, është që të sjellë ndërmend faktin se ‘Shpërblimi jepet sipas veprës’.

Njeriu nuk duhet të harrojë se edhe ai vet është mëkatar dhe gabimtar, e nëse ai ua fal gabimin të tjerëve, ka për të qenë më i meritueshëm për faljen dhe mëshirën e Allahut të Madhëruar - Mëkatfalësit të Gjithëmëshirshëm.

Allahu i Madhëruar thotë:

هَلْ جَزَاءُ الْإِحْسَانِ إِلَّا الْإِحْسَانُ

A mund të jetë shpërblimi i veprës së mirë diçka tjetër, përveç të mirës! Err Rrahman, 60.

Kështu pra, sa herë që vetja jote të nxit për t’iu hakërryer ndokujt që ka gabuar kundrejt teje, sill ndërmend faktin se edhe t’i je gjynahqar. Fali njerëzit, mëshiroji ata që të meritosh faljen dhe mëshirën e Allahut!

Cilido që sjell ndërmend këtë fakt, e ka shumë më të lehtë të tregohet i durueshëm dhe falës me ata që kanë gabuar kundrejt tij, e sikur njeriu i logjikshëm vetëm këtë fakt të meditonte, do t'i mjaftonte.

HAKMARRJA PËR VETEN BIE NDESH ME TRADITËN PROFETIKE

Dije se të hakmerresh për veten tënde, bie ndesh me traditën profetike, pasi i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) nuk hakmerrej kurrë për veten e tij, me përjashtim të rasteve kur nëpërkëmbeshin dispozitat dhe urdhëresat e Allahut të Madhëruar.

Ne e kemi shëmbëlltyrën më të mirë tek i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!). Allahu i Madhëruar thotë:

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ

“Ju e kishit shembullin më të mirë tek i Dërguari i Allahut” El Ahzab, 21.

I Dërguari i Allahut; krijesa më e nderuar dhe më fisnike e Zotit, u lëndua dhe u mundua nga njerëzit, por ai asnjëherë nuk pranoi të hakmerrej për veten e tij, kështuqë edhe muslimanit nuk i takon të hakmerret për veten e tij.

I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) ishte njeriu më i mirë që ka shkelur mbi sipërfaqen e tokës. Ai kishte moralin dhe virtytet më të larta dhe ishte më i denji që njerëzit ta respektonin dhe të tregoheshin të bindur ndaj tij, pasi ai gjithnjë përpigjej për udhëzimin dhe shpëtimin e tyre, e megjithatë, edhe kur njerëzit nuk ia njohën pozitën dhe vlerën e u treguan të ashpër e të vrazhdë me të, ai përsëri nuk ua ktheu në të njëjtën mënyrë.

E si mundemi ne që të hakmerremi për veten tonë kur e njohim atë më mirë se çdokush tjetër dhe ia dimë të metat dhe ligësitë. Njeriut që e njeh mirë veten e tij, nuk i takon që të hakmerret për të.

Të shpejtosh për t'i dalë në mbrojtje vetes tënde sa herë që dikush gabon kundrejt teje, madje edhe kur ndeshesh me kritikën më të vogël, kjo tregon se ti e mbivlerëson veten tënde dhe nuk e njeh realitetin e saj.

Njeriu i vetëdijshëm për mëkatet e veta, mangësitë dhe dobësitë e tij të shumta, nuk shpejton t'i dalë në mbrojtje vetvetes, por angazhohet të përmirësojë moralin dhe sjelljen e tij, pasi në të vërtetë, vetëm kjo do t'i bënte dobi, si në këtë botë, ashtu dhe në botën tjetër.

TË FALËSH ËSHTË MË E LEHTË

Nëse njeriu fokusohet tek hakmarrja dhe kërkimi i dëmshpërblimit për dëmin që i është shkaktuar, kjo do t'i marrë shumë kohë dhe energji, si dhe do t'i shkaktojë stres dhe mundim. Kjo mund t'i kushtojë shumë më tepër sesa vet dëmi që i është shkaktuar.

Nëse njeriu tregohet tolerant dhe falës, zemra dhe mendja e tij do të jenë të qeta dhe të gatshme për punë shumë më të dobishme dhe të frytshme sesa dëshira për t'u hakmarrë ndaj atyre që kanë gabuar kundrejt tij.

PA LODHJE DHE MUND NUK KA SHPËRBLIM

Nëse njeriu është duke u ballafaquar me lodhje dhe vështirësi për shkak të ndonjë vepre të mirë që është duke e kryer për hir të Allahut, apo për shkak se po përpiqet për udhëzimin e njerëzve dhe këshillimin e tyre, atëherë ky duhet patjetër të bëjë durim, pasi përpjekja e tij është në rrugë të Zotit dhe Ai do ta shpërblejë për të.

Ky është motivi që i ka nxitur dëshmorët dhe dijetarët të sakrifikojnë gjithçka të shtrenjtë për hir të Allahut të Madhëruar, pasi ata ishin të bindur se përpjekja e tyre nuk ishte duke shkuar kot, sepse Zoti i Madhëruar ka garantuar shpërblimin më të mirë për të, ashtu siç thotë në Kuranin fisnik:

إِنَّ اللَّهَ اشْتَرَىٰ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ أَنفُسَهُمْ وَأَمْوَالَهُمْ بِأَنَّ لَهُمُ الْجَنَّةَ

“Vërtetë, Allahu ka blerë prej besimtarëve vetet dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit”

Et Teube, 111.

Kështu pra, shpërblimi për lodhjen dhe mundin e tij, është tek Zoti, dhe ai nuk ka përse e kërkon atë tek njerëzit.

Nëse ai e kërkon shpërblimin e lodhjes dhe mundit tek njerëzit, atëherë nuk i mbetet më asgjë tek Zoti, pasi Allahu kompeson dhe shpërblen vetëm për kontributin që është dhënë për hir të Tij dhe që shpresohet shpërblimi prej Tij. Vetëm ajo çfarë jepet për hir të Allahut, shpërblehet prej Tij.

Nëse vuajtja dhe mundimi i vijnë nga ndonjë fatkeqësi që i ka rënë, atëherë le ta kërkojë shkakun e asaj fatkeqësie tek të këqijat që ka vepruar, pasi ashtu siç e kemi thënë edhe më herët, çdo fatkeqësi që e godet njeriun, është pasojë e mëkateve që ka punuar. Në këtë rast, njeriut i takon të rishikojë punët e veta dhe jo ta kërkojë shkakun e fatkeqësisë së tij tek të tjerët.

Megjithatë, ekziston edhe mundësia që vuajtja dhe mundimi i tij, të jenë sprovë që ia ka caktuar Allahu i Madhëruar, e në këtë rast, njeriu duhet patjetër të bëj durim, pasi vetëm kështu do ta kalonte me sukses atë sprovë që i ka rënë.

Të durosh gjatë fatkeqësive mund të jetë shumë e rëndë dhe e vështirë, mirëpo të humbasësh shpërblimin e madh që ka durimi në të tilla raste, është fatkeqësi më e madhe se vet fatkeqësia!

Le të japim një shembull: Tregtari i cili niset me karvanin e tij drejt vendeve të largëta dhe shkretëtirave të gjera, nëse nuk do të duronte nxehtësinë përvëluese apo të ftohtin e acartë me të cilin mund të ballafaqohet gjatë udhëtimit, shtoji këtu rrezikun që mund t'i kanoset nga grabitësit e rrugëve apo kafshët e egra, atëherë do të duhej që ai vetëm të ëndërronte për shpërblimin dhe fitimin e shumdëshiruar, por ai i merr parasysh të gjitha këto, i mbështetet Allahut dhe niset, pasi e ka të qartë se pa lodhje dhe mundim nuk ka sukses dhe as fitim. Kjo është diçka e njohur dhe e pranuar nga të gjithë.

Nëse njeriu nuk është i gatshëm të durojë dhe të sakrifikojë diçka nga vetja e tij për të arritur shpërblimin dhe për të përmbushur synimin, atëherë ai s'mund të jetë serioz dhe i sinqertë në atë që dëshiron të arrijë, por vetëm sa ëndërron me sy hapur.

ALLAHU ËSHTË ME DURIMTARËT

Ndër faktorët që e ndihmojnë njeriun të jetë i durueshëm kundrejt shqetësimeve dhe dëmeve që i shkaktojnë të tjerët, do t'i mjaftonte fakti se Allahu është me durimtarët. Ai i do dhe i përkrah ata. Allahu i Madhëruar thotë:

وَأَصْبِرُوا ۖ إِنَّ اللَّهَ مَعَ الصَّابِرِينَ

“Bëni durim, se vërtetë Allahu është me durimtarët.” El Enfal, 46.

Në një tjetër ajet, thotë:

وَاللَّهُ يُحِبُّ الصَّابِرِينَ

“Allahu i do durimtarët.” Ali Imran, 146

Çdo njeri të cilit i është bërë ndonjë padrejtësi, le të sjellë ndërmend faktin se Allahu është pranë Tij; Ai është hollësisht i njohur për gjendjen e robit të Tij, dhe mundet t’ia largojë të keqen dhe dëmin që i ka rënë.

Për Allahun e Madhëruar asgjë nuk është e pamundur, kështu që bëj durim dhe shpresat e tua mbaji vetëm tek Ai!

DURIMI ËSHTË GJYSMA E BESIMIT

Siç dihet, 'durimi' gjatë vështirësive dhe sprovave është gjysma e besimit (ndërsa gjysma tjetër është falënderimi për mirësitë e panumërta).

Në çdo moment të jetës së tij, njeriu është duke përjetuar njërën nga këto dy gjendje:

1. Ai, ose është në një gjendje lodhjeje, vështirësie, sëmundjeje dhe mundimi, e në të tilla raste ka nevojë të pajiset me virtytin e durimit, pra të durojë për hir të Zotit të Madhëruar duke llogaritur shpërblimin e tij.
2. Ose është në rehati e mirësi, ku gëzon siguri, lumturi, shëndet e furnizim të bollshëm, e kjo gjendje duhet ta nxis njeriun për të qenë falënderues dhe mirënjohës ndaj Zotit të Madhëruar.

Duke u nisur nga kjo, është thënë se durimi është gjysma e besimit.

Besimtari nuk pranon ta humbasë gjysmën e besimit të tij duke u treguar i paduruar dhe duke u hakmarrë ndaj atyre që kanë gabuar kundrejt tij.

Nëse ai bën durim dhe e frenon zemërimin, atëherë e ka mbrojtur besimin e tij. E duke vepruar në këtë mënyrë, ai ka merituar mbrojtjen e Allahut të Madhëruar, i Cili thotë:

إِنَّ اللَّهَ يُدَافِعُ عَنِ الَّذِينَ آمَنُوا

“S’ka dyshim që Allahu u del në mbrojtje atyre që besuan.” El Haxh, 38

DURIM DO TË THOTË NGADHËNJIM MBI VETEN DHE EGON E SAJ

Durimi është virtyt shumë i vyer. Askujt nuk i është dhënë mirësi më e madhe sesa durimi.

Njeriu i cili tregohet i durueshëm kundrejt fyerjeve apo shqetësimeve që i shkaktojnë njerëzit, është njeri i fortë dhe i disiplinuar.

I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) thotë:

“Nuk është i fortë ai që e mund tjetrin në dyluftim, por i fortë është ai, që e përmban veten kur është i zemëruar (i nxehur)”¹¹

Hadithi profetik na nxit që ta luftojmë egon (nefsin), si dhe ta mbizotërojmë dëshirën për triumf dhe hakmarrje ndaj atyre të cilët na kanë zemëruar apo nervozuar.

Të durosh në të tilla raste duke e mposhtur nefsin (egoizmin) nuk është e lehtë. Për këtë arsye, Profeti (Paqja qoftë mbi të!), e ka quajtur “luftëtarin më të

¹¹ E transmetojnë Buhariu me nr 5763 dhe Muslimi me nr 2609.

madh” pikërisht atë që përpiqet vazhdimisht për të triumfuar mbi nefsën e tij, në mënyrë që ta sjellë atë në rrugë të mbarë,

Njeriu i cili e ka nën kontroll nefsën dhe egon e tij, ka mbrojtur vetveten nga telashe dhe rreziqe të shumta.

Ndërsa në krahun tjetër, ta lëshosh pa fre dëshirën për hakmarrje dhe ndëshkim, duke mos qenë në gjendje të kontrollosh ndjenjat dhe emocionet, do të thotë t’i hapësh vetes dhe të tjerëve derën e shkatërrimit.

Sikur njeriu të mos përfitonte nëpërmjet durimit asgjë tjetër përveç triumfit ndaj vetvetes dhe zbrapsjes së cytjeve të shejtanit, kjo do të ishte mëse e mjaftueshme. Por frytet e durimit janë të shumta, dhe vetëm nëpërmjet tij arrihet lumturia, krenaria dhe fitorja.

KUSH TREGOHET I DURUESHËM PËR HIR TË ALLAHUT, FITON MBROJTJEN E TIJ

Allahu është Mbrotjësi dhe Ndhimëtari i atyre të cilëve u është bërë padrejtësi.

Ai njeri i cili nuk hakmerret për veten e tij, edhe pse i ka mundësitë për ta bërë një gjë të tillë, do të thotë se ai dëshiron që hakun e tij ta ketë të ruajtur tek Zoti i Madhëruar. Për këtë arsye, zullumqarin ia ka dorëzuar Allahut. E ku ka mbrotjtës dhe ndihmëtar më të mirë se Zoti i gjithësisë?!

Sahabiu i nderuar, Ebu Hurejra tregon: “Një burrë po e fyente Ebu Bekër Es Sidikun (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) e aty ndodhej edhe i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) i cili buzëqeshte, i kënaqur nga vetpërmbytja dhe durimi i Ebu Bekrit.

Në një moment kur burri e teproi me fjalët e tij, Ebu Bekri ia ktheu atij me disa fjalë. Në atë moment, i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) tregoi pakënaqësi dhe u ngrit të lartë.

Ebu Bekri i shkoi pas dhe e pyeti: “O i Dërguari i Allahut! Ai burrë po më fyente, dhe ti ishe

prezent. Kur unë ia ktheva me disa fjalë, ti u mërzite dhe u largove.

I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Aty ishte një engjëll o Ebu Bekër, i cili sa herë që ai të shante, engjëlli ia kthente në vendin tënd, deri në momentin që t’i nise vetë t’ia kthesh ofendimin, atëherë aty erdhi shejtani, e unë nuk qëndroj aty ku rri shejtani. – Pastaj tha:

Tre gjëra janë mëse të vërteta o Ebu Bekër: ‘Nuk ndodh që dikujt t’i jetë bërë padrejtësi e ai të bëj durim për hir të Allahut, veçse Allahu do ta ndihmojë e do t’ia shtojë krenarinë.

Nuk ndodh që dikush të japë diçka nga pasuria e tij duke dashur që nëpërmjet saj të afrojë mes njerëzve (ta shtojë dashurinë dhe miqësinë), veçse Allahu ka për t’ia shtuar edhe më shumë pasurinë dhe bereqetin.

Dhe nuk ndodh që dikush t’u kërkoj njerëzve sadaka (lëmshë) jo nga nevoja, por që ta shtojë edhe më shumë pasurinë, veçse do t’i shtohet edhe më tepër varfëria.”¹²

¹² Hadithin e transmeton imam Ahmedi në “Musnedin” e tij vëllimi: 2, faqja: 436 me nr 9622, El Bejhekiu në “Es Suneni el Kubra” Vëllimi: 10, faqja: 400, me nr 21096 etj. Shejkh Albani e ka vlerësuar këtë hadith si *Hasen – I mire*. Shiko librin “Es Silsiletu Es Sahiha” vëllimi: 5, faqja: 271.

Kështu pra, njeriu i cili kërkon të hakmerret për veten e tij, duke u mbështetur vetëm në forcat e veta, e privon veten nga mbrojtja dhe ndihma e Allahut të Madhëruar, pasi do të lihet t'ia dalë mbanë vet, pa ndihmën dhe suksesin e Allahut. Por, a mund të ketë të krahasuar mes atij që i del në ndihmë Allahu, dhe atij që ka marrë për mbrojtës veten e tij të dobët e mesquine?!

**KTHEJE TË KEQEN ME TË MIRË,
PËR T'I DHËNË FUND ARMIQËSISË!**

Durimi dhe vetpërmbajtja ndaj atyre që kanë gabuar ndaj teje, apo të kanë bërë padrejtësi, i nxit ata të pendohen dhe të ndjejnë keqardhje për sjelljen e tyre të gabuar.

Ndodh shpesh që duke e kthyer të keqen me të mirë, kundërshtari yt të vijë tek ti kokëulur, ta pranojë gabimin e të kërkojë ndjesë për sjelljen e tij jo të hijshme. Jo vetëm kaq, por sjellja e mirë ndaj atij që të ka lënduar, ia zbut zemrën dhe ia largon urrejtjen ndaj teje, duke e shëndërruar; nga njeri dashakeqës e armiqësor, në mikun tënd më të afërt. Ky është kuptimi i ajeteve që i gjejmë në suren 'El Fussilet'.

Allahu i Madhëruar thotë:

وَلَا تَسْتَوِي الْحَسَنَةُ وَلَا السَّيِّئَةُ ۗ ادْفَعْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ فَإِذَا
الَّذِي بَيْنَكَ وَبَيْنَهُ عَدَاوَةٌ كَأَنَّهُ وَلِيٌّ حَمِيمٌ وَمَا يُلْقَاهَا إِلَّا الَّذِينَ
صَبَرُوا وَمَا يُلْقَاهَا إِلَّا ذُو حَظٍّ عَظِيمٍ

“Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Të keqen ktheje me mirësi, se atëherë ai, mes teje dhe të cilit ka armiqësi, do të bëhet si të ishte miku yt më i afërt. Mirëpo, këtë nuk e arrin kush, përveç atyre që janë të durueshëm, dhe nuk e arrin kush, përveç atyre që gëzojnë një mirësi të madhe.” El Fussilet, 34-35

**NJERIU I MENÇUR NUK MUNDOHET
TË ELEMINOJË DËMIN E VOGËL DUKE
SHKAKTUAR NJË DËM MË TË MADH**

Njeriu i cili kërkon të hakmerret për veten e tij, duhet ta ketë të qartë se hakmarrja mund ta nxisë kundërshtarin ta shtojë ligësinë dhe armiqësinë kundrejt tij duke u bërë edhe më armiqësor¹³.

Njeriu i mençur nuk mundohet të eliminojë dëmin e vogël duke shkaktuar një dëm më të madh. Sa e sa njerëz ia kanë hapur derën e shkatërrimit vetes dhe të afërmëve të tyre duke i shkuar sherrit pas, gjë e cila u ka sjellë pasoja të rënda, madje edhe humbje të jetëve të pafajshme, shpërdorim të pasurive dhe energjive, e gjitha në shërbim të një hakmarrjeje shterpë! E sikur njeriu të tregohet i duruar e i matur për një çast, do t'i kishte shmangur të gjitha këto pasoja të këqija.

¹³ Nje njeri i urtë ka thënë: “Kush dëshiron të fillojë një udhëtim hakmarrjeje, duhet të bëjë gati dy varre, një për vete dhe një për hasmin e tij.”

KUSH TREGOHET I DURUESHËM**DHE FAL, E RUAN VETEN NGA E KEQJA.**

Njeriu i cili zgjedh ndëshkimin në vend të faljes, ndodh shpesh që të bëjë padrejtësi e t'i kalojë caqet gjatë ndëshkimit.

Kjo ndodh pasi njeriu e ka të vështirë të mjaftohet me cakun që kërkon e drejta, e sidomos në gjaknxehtësi e sipër. Shto këtu edhe faktin se ai mund të jetë i paditur në lidhje me masën e hakut (të drejtës) që i takon ta marrë tek tjetri, apo në lidhje me mënyrën e ndëshkimit të tjetrit për dëmin që ky i fundit i ka shkaktuar.

Shumë njerëz, duke dashur të hakmerren për ndonjë padrejtësi që mund t'u jetë bërë, shndërrohen në njerëz inatçorë, që flasin dhe veprojnë në mënyrën më të papërgjegjshme. Të përfshirë nga mllëfi dhe inati dhe nga dëshira për hakmarrje, ata shndërrohen në zullumqarë që e kthejnë të keqen shumëfish.

Është për t'u lavdëruar njeriu, të cilit, nëse i bëhet padrejtësi, duron, por njëkohësisht e kërkon të drejtën që i takon, ama në mënyrë të ligjshme. Në të vërtetë, ky qëndrim burror i karakterizuar nga durimi dhe vetpërmbajtja, vetëm sa ia shton krenarinë dhe dinjitetin. Përndryshe, urrejtja dhe dëshira për hakmarrje, mund ta shëndërrojnë në një zullumqar e kriminel, për shkak të hakmarrjes së tepruar.

**PADREJTËSIA DHE DËMI I SHAKTUAR,
BËHEN SHKAK QË I DËMTUARI TË
PASTROHET NGA GJYNAHET**

Kur njeriu sprovohet me padrejtësi nga ana e njerëzve dhe tregohet i duruar e i matur, kjo do t'i shërbejë atij për t'u pastruar nga mëkatet dhe për t'u ngritur në pozita të larta të besimit. Por nëse njeriu hakmerret e nuk bën durim, e humbet mundësinë për t'u pastruar nga mëkatet e për t'u ngritur në pozita të besimit.

NJERËZIT SOLIDARIZOHEN ME ATË QË I ËSHTË BËRË PADREJTËSI

Njerëzit solidarizohen me atë që i është bërë padrejtësi, e sidomos kur shohin prej tij maturi dhe durim. Kjo e vë keqbërësin në pozitë të sikletshme, pasi i duhet të përballet me kritikën dhe qortimet e njerëzve.

Ndërsa, nëse njeriu i jep përparësi hakmarrjes në vend të durimit dhe faljes, kjo bën që ta humbasë mbështetjen e njerëzve, pasi ai tashmë po e kthen të keqen me të keqe, dhe dëmin me dëm; pra, po vepron njësoj si kundërshtari i tij. Në këtë rast njerëzit tërhiqen mënjane dhe nuk interesohen më se cila palë ngadhënjën ndaj tjetrës.

**DURIMI DHE FALJA E MPOSITIN
KUNDËRSHTARIN MË TEPËR
SE HAKMARRJA**

Disa njerëz që shajnë e mallkojnë të tjerët, ndjehen ngushtë deri në momentin kur kundërshtari fillon t'ua kthejë në të njëjtën mënyrë. Vetëm atëherë, ata çlirohen nga ndjenja e fajit dhe gjejnë lehtësim.¹⁴

Jo vetëm kaq, por kush tregohet i durueshëm dhe fal, edhe pse ka mundësi të hakmerret, ai në një farë mënyre, e ka mposhtur kundërshtarin. Kjo ndodh sepse durimi dhe falja janë tregues të forcës së karakterit dhe bëjnë që kundërshtari ta ndjejë veten të dobët dhe më të ulët përballë atij që është treguar tolerant me të. E natyrisht që ky fakt do të mjaftonte për të kuptuar vlerën e faljes dhe durimit.

¹⁴ Një njeri i urtë ka thënë: “Duroi fyerjet e të ligut, se durimi yt atë e vret. Zjarri djeg veten e tij, kur nuk ka se çfarë të djegë.”

VEPRAT E MIRA
PASOJNË NJËRA-TJETRËN

Të durosh dhe t'ua falësh njerëzve gabimin, është ndër veprat më të mira, e siç dihet, kur njeriu bën një vepër të mirë, kjo i hap shtegun një tjetër vepre të mirë. Siç dihet, veprat e mira pasojnë njëra-tjetrën, ashtu siç veprat e këqija ndjekin njëra-tjetrën. Fatlum është ai njeri që i shtohen sevapet duke bërë vepra të mira, pasi ndoshta ato vepra mund të jenë shkaku i lumturisë së pashtershme në dynja dhe ahiret. Falua njerëzve gabimin që të mos e humbasësh shpërblimin, e mos ushqe hakmarrje!



PËRMBAJTJA

Parathënie e shejhut të nderuar Abdurrazak Bin Abdulmuhsin El Bedër	3
Faktorët që e nxisin njeriun të jetë i durueshëm kundrejt shqetësimeve që i shkaktojnë të tjerët	17
Sill ndërmend gjynahet e tua!	19
Kush fal e duron, shpërblimin e ka tek Zoti	21
Falja e forcon ndjenjën e vëllazërisë dhe e largon urrejtjen	22
Hakmarrja nuk sjell gjë tjetër përveçse mërzi dhe dëshpërim	26
Shpërblimi jepet sipas veprës	27
Hakmarrja për veten bie ndesh me traditën profetike	29
Të falësh është më e lehtë	31
Pa lodhje dhe mund nuk ka shpërblim	32



Allahu është me durimtarët	35
Durimi është gjysma e besimit	36
Durim do të thotë ngadhënjim mbi veten dhe egon e saj	38
Kush tregohet i durueshëm për hir të Allahut, fiton mbrojtjen e tij	42
Ktheje të keqen me të mirë, për t'i dhënë fund armiqësisë!	43
Njeriu i mençur nuk mundohet të eliminojë dëmin e vogël duke shkaktuar një dëm më të madh	45
Kush tregohet i durueshëm dhe fal, e ruan veten nga e keqja.	46
Padrejtësia dhe dëmi i shaktuar, bëhen shkak që i dëmtuari të pastrohët nga gjynahet	48
Njerëzit solidarizohen me atë që i është bërë padrejtësi	59
Durimi dhe falja e mposhtin kundërshtarin më tepër se hakmarrja	50
Veprat e mira pasojnë njëra-tjetrën	51

